



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "WISDOM"

Rruga "Medar Shtylla", (Komuna e Parisit), Tiranë, www.wisdom.al. tel: 042200063; cel: 0676022736

RREGULLORE E BIBLIOTEKËS

- Në zbatim të Ligjit nr. 8576, datë 03.02.2006 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr. 9217, datë 08.04.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8576, datë 03.02.2006 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" hartohet dhe miratohet kjo rregullore me permbajtje si vijon:
- 1- Biblioteka e Kolegjit Universitar "Wisdom" ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës universitare dhe është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore të përdoruesve të saj.
 - 2- Ajo ofron shërbim kulturor dhe informues, realizon hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Grumbullon, ruan, përpunon dhe vë, në shërbim të përdoruesve materiale bibliotekare në përshtatje me kërkesat arsimore, shkencore dhe kulturore të tyre.
 - 3- Siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës.
 - 4- Është vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik një numër i konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literature ndihmëse në bibliotekën e Kolegjit Universitar "Wisdom".
 - 5- Biblioteka e Kolegjit Universitar "Wisdom" në varësi të organit të emërtesës, ka të drejtën e pasurimit të fondit të bibliotekës në mbështetje të kërkesave të studentëve dhe stafit akademik për literaturën e nevojshme në shërbim të formimit të tyre profesional.
 - 6- Biblioteka mund të përfitojë ndihma financiare dhe materiale nga burime të tjera, individë, fondacione, organizata shoqërore vendase e të huaja. Ajo ka për detyrë të vërë në dijeni organin e emërtesës, për çdo përfitim të mundshëm në vlerë monetare dhe materiale si: libra print, CD-ROM apo dixhitale si: libra on-line, në formatin PDF.
 - 7- Biblioteka e Kolegjit Universitar "Wisdom" ofron shërbim bibliotekar për përdoruesit e saj, nga e Hëna në të Premten, ora 8:30 deri 19:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "WISDOM"

Rruga "Medar Shtylla", (Komuna e Parisit), Tiranë, www.wisdom.al. tel: 042200063; cel: 0676022736

PËRDORUESIT E BIBLIOTEKËS KANË TË DREJTË :

- 1- Të marrë informacion për koleksionet e bibliotekës dhe për koleksionet e bibliotekave të tjera nëpërmjet mjeteve tradicionale dhe elektronike të informacionit bibliotekar.
- 2- Të ndihmohet për kërkim dhe zgjedhje të botimeve informative.
- 3- Të shfrytëzojë koleksionet e bibliotekës në mjediset e saj, të huazojë materiale bibliotekare sipas rregullores.
- 4- Të shfrytëzojë në qetësi sallën e leximit në çdo kohë që ka nevojë dhe të mbajë pastër hapësirën e tij që ka në përdorim.
- 5- Të shfrytëzojë internetin, duke kërkuar informacionin ndihmës në website-t e këshilluara nga pedagogët e lëndëve përkatës
- 6- Të huazojë libra nga biblioteka në afatin 20-25 ditë, nëse tejkalon afatin e dorëzimit, taksohet me 2 % të vlerës, për çdo ditë të vonuar.
- 7- Duhet të jetë student apo pjesë e stafit akademik e administrativ, që të mund huazojë libra në bibliotekë. Duhet të ketë kartelën e tij të anëtarësimit, që tregon se është anëtar i bibliotekës. Në çdo rast të huazimit të librave paraqet dokumentin personal ID e cila depozitohet në kartelën personale dhe e merr atë përseri pasi ka dorëzuar librin e huazuar në bibliotekën e universitetit
- 8- Të paguajë për dëmin material dhe ekonomik që mund të shkaktojë për çdo material bibliotekar dhe kompjuterik. Në çdo rast të dëmit, taksohet me tre fishin e vlerës reale të mallit të dëmtuar. Niveli i dëmtimit do vlerësohet nga bibliotekarja që është përgjegjëse për ruajtjen e gjithë materialit bibliotekar dhe nga Administratorja e Shoqërisë Wisdom, që kontrollon aktivitetin bibliotekar.
- 9- Të respektojë rregulloren e bibliotekës.

